



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA GLLOGOC  
GLLOGOC MUNICIPALITY

Pranuar

29.11

2018

Nj. Org.

Numër

Shtoja

Vlera

09 MO-8150



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA DRENAS  
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

Në mbështetje të nenit 31 paragrafi 31.1. të Ligjit për Arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, Drejtoria Komunale për Arsim në Drenas në bazë të autorizimeve të përcaktuara sipas statutit të Komunës, dhe duke u mundësuar lejimin në modifikime eventuale të rregullorës unike për ta harmonizuar varësisht nga specifikat që mund t'i ketë Shkolla me propozimin paraprak të Këshillit të saj, DKA i propozon Shkollave fillore të mesme të ulëta këtë:

**RR E G U L L O R E**  
**PËR SJELJJEN E NXËNËSVE NË SHKOLLË**

**I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këto rregulla përcaktohen të drejtat, detyrat, obligimet për sjellje dhe disiplinë të nxënësve në shkollë.

**Neni 2**

Marrja e masave disiplinore aplikohet nëse nxënësi nuk i respekton rregullat e sjelljes të përcaktuar nga shkolla.

**Neni 3**

“Nxënës”- konsiderohet çdo i ri (e re) vijues në çfarëdo programi për arsimin fillor ose të mesëm (publik apo privat), respektivisht nxënësi është vijues i shkollimit parauniversitar.

**Neni 4**

Shkollimi „fillor” dhe „i mesëm i ulët”, fillon atë fillimviti shkollor, kur fëmija t'i ketë mbushur gjashtë (6) vjet, kurse përfundon në atë fundviti shkollor, kur nxënësi të ketë mbaruar klasën e nëntë (IX), respektivisht në datën kur nxënësi t'i ketë mbushur pesëmbëdhjetë (15) vjet moshë.

## II - TË DREJTAT E NXËNËSIT

### Neni 5

#### **Nxënësi gjatë qëndrimit në shkollë ka të drejtë:**

- 5.1 t'i realizojë të drejtat e përcaktuara me Ligjin mbi Arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës;
- 5.2 të njohë Konventat ndërkontaktore për të drejtat e fëmijëve dhe të kërkoi respektimin e tyre;
- 5.3 të shprehë mendimin me gojë e me shkrim për problemet që e shqetësojnë atë, klasën e tij dhe shkollën;
- 5.4 t'i respektohet dinjiteti moral dhe fizik;
- 5.5 të marrë pjesë në mbledhje të nxënësve të klasës dhe të shkollës;
- 5.6 të zgjedhë dhe të zgjidhet në Këshillin e nxënësve të klasës dhe Këshillin e nxënësve të shkollës;
- 5.7 të marrë pjesë në veprimtaritë kulturore, artistike dhe sportive, të cilat i organizon klasa ose shkolla;
- 5.8 të marrë mirënjojje dhe shpërblime për sukseset e jashtëzakonshme në mësim, në gara të diturisë në aktivitetet kulturore dhe sportive;
- 5.9 të marrë dokumentin përkatës për klasën e kryer dhe dokumentet tjera të nevojshme për nxënësin, të cilat i lëshon shkolla;
- 5.10 nxënësi që ka pasur nga klasa e I-rë--IX të gjitha notat pesëshe të shpërblyhet me Falënderim;
- 5.11 të realizoi edhe të drejtat tjera, të cilat janë në interes të nxënësit;

## III - DETYRAT DHE OBLIGIMET E NXËNËSIT

### Neni 6

#### **Nxënësi gjatë qëndrimit në shkollë ka për detyrë dhe obligim që:**

- 6.1 të respektojë rregullat përendin shtëpiak të shkollës;
- 6.2 të respektojë orarin mësimor dhe orarin e aktiviteteve të lira;
- 6.3 të vijë në shkollë i pajisur me tekste dhe me mjete mësimore;
- 6.4 të bartë uniformën ose shenjën e përcaktuar të shkollës, të ketë pamje dhe veshje modeste;
- 6.5 nxënësi nuk guxon të bëjë lëvizje në lokalet e shkollës gjatë kohës së mësimit, pa lejën e personelit arsimor;
- 6.6 të mbajë qëndrim të mirë në orë mësimore, në ambientet shkollore, në rrugë për në shtëpi;
- 6.7 të këtë sjellje të veçanta ndaj fëmijëve jetim dhe atyre me aftësi të kufizuara;
- 6.8 të këtë sjellje korrekte ndaj shokëve të klasës, nxënësve të gjinisë tjeter, të përkatsisë tjeter fetare, ndaj arsimtarëve dhe personelit tjeter të shkollës;
- 6.9 të ruaj dhe të humanizojë ambientin shkollor dhe
- 6.10 detyrat e obligime të tjera, të cilat i përcaktojnë organet profesionale dhe qeverisësë të shkollës.

## IV - MASAT DISIPLINORE

### Neni 7

7.1. Nëse nxënësi nuk i respekton rregullat e sjelljes në shkollë, atëherë kundër tij shqiptohën masat disiplinore

7.2. Masat disiplinore janë:

- a) Paralajmërimi, përkatësisht qortimi;
- b) Vërejtja me shkrim;
- c) Përjashtimi i përkohëshëm i nxënësit për të marrë pjesë në aktivitete të lira ;
- ç) Thyerja e notës së sjelljes;
- d) Ndërrimi i paralelës dhe
- dh) Ndërrimi i shkollës

7.3. Masën disiplinore të paralajmërimit, përkatësisht të qortimit e shqipton kujdestari i klasës;

7.4. Masat disiplinore: vërejtje me shkrime , përjashtim i përkohëshëm nga aktivitetet e lira , ndërrimi i paralelës dhe thyrjen e notës se sjelljes e shqipton drejtori i shkollës;

7.5. Masën disiplinore - ndërrimi i shkollës e shqiptaon Komisioni disiplinorë;

7.6. Masa disiplinore - ndërrimi i shkollës aplikohët në marrëveshje me shkollat për rreth dhe me pëlqimin e Drejtorisë së Arsimit të Komunës;

7.7. Masa disiplinore ndërrimi i shkollës mund t'ju shqiptohët vetëm nxënësve prej klasës së VI-të deri në të IX-tën.

### Neni 8

8.1. Paralajmërimi, përkatësisht qortimi i shqiptohët nxënësit për :

- a) mosekryrjen e obligimeve të përcaktuara nga drejtuesit e shkollës;
- b) ndotjën e ambientit në klasë dhe në shkollë;
- c) sjellje fyeze ndaj shokëve të klasës;
- ç) pranimin dhe sjelljen e personave të pa dëshiruar në shkollë;
- d) shqetësimin që mundë të iu sjellë të tjerve nëpermjet shushurimës, zhurmës dhe sjellëjeve arrugante e të tjera.

8.2. Paralajmërimi ose qortimi, nxënësit i shqiptohët në klasë dhe para këshillit të nxënësve të klasave përkatëse.

### Neni 9

9.1. Masa disiplinore vrejtje me shkrim i shqiptohet nxënësit për;

- a) ç'rregullimin e mësimit;
- b) sjellje jo korakte ndaj shokëve të klasës, nxënësve te gjinisë tjeter, të perkatësisë tjeter fetare dhe ndaj mësimëdhënësve;
- c) pirje të duhanit;
- ç) përdorimin e telefonave cellular në shkollë,
- d) bartjen e gjësendeve të rrezikshme në shkollë( brisku, thika, boksi i hekurit etj);

e) deri në 8 mungesat të paarsyshme nga orët mësimore etj,

9.2. Vërejtje me shkrim lexohet para nxënësve të shkollës dhe një kopje i dorëzohet prindit të nxënësit.

## Neni 10

10.1. Përjashtimi i përkohëshëm i nxënësit për të marrë pjesë në aktivitet e lira bëhet për;

- a) prishjen e disiplinës gjatë organizimit të aktiviteteve të lira;
- b) mosëkryrjen e detyrave të dhëna nga mësimdhënësit e shkollës;
- c) cenimin e dinjitetit të shokëve/shoqeve të klasës edhe të nxënësve tjerët të shkollës
- ç) mosëzbatimin e rregullave të aktiviteteve të lira etj.

## Neni 11

11.1. Nota e sjelljes nxënësit i thehet pér ;

- 10 mungesa të paarsyeshme, nota e sjelljes i zbritet në 4;
- prej 10 -15 mungesa të paarsyshme, nota e sjelljes nxënësit i zbritet në 3;
- prej 15-25 mungesa të paarsyshme , nota e sjelljes i zbritet në 2;
- mbi 25 mungesa të paarsyeshme, nota e sjelljes nxënësit i zbritet në1.

11.2. Nota e sjellejes , nxënësit mund t'i thehet edhe pér sjellje të keqe në shkollë.

## Neni 12

12.1. Masa disiplinore - ndërrimi i shkollës aplikohet për nxënësit të cilët;

a) fyejn arsimtaret e punëtorët tjerë të shkollës dhe i pengojnë ata në kryrjen e detyrave në shkollë e jashtë saj;

b) pengojnë me qëllim nxënësit tjerë për të hyrë në mësim dhe për të marrë pjesë në aktivitete jashtë mësimore;

c) falsifikojnë të dhënat në dokumente shkollore ( në libra të klasës, libra amë, librezë e dëftesa);

c) vjedhin dhe shkatërrojnë pasurinë e nxënëve, të mësimdhënësve dhe të shkollës;

d) shkaktojnë rrahje në ambientet e shkollës;

dh) sjellin në shkollë armë dhe lëndë plasëse e gjësende tjera vdekjeprurëse ;

e) paraqesin në provim personin tjetër në vend të tij dhe anasjelltas;

ë) sjellin në shkollë dhe përdorin lëndë narkotike.

12.2. Nëse nxënësi shkatërron inventarin shkollor, mjetet mësimore dyert e dritaret ose ndonjë gjësend tjetër të shkollës, prindi i tij është i obliguar që të paguaj dënimin në shumën që ia përcakton komisioni disiplinor, përkatësisht komisioni profesional i shkollës.

12.3. Vendimi për ndërrimin e shkollës, i dorëzohet prindit të nxënësit.

12.4. Kundër vendimit të komisionit të shkollës, prindi i nxënësit ka të drejë ankesë në Drejtorinë Komunale për Arsim në afatin prej 8 ditësh prej ditës së pranimit të vendimit. Ankesa paraqitet nëpërmes drejtorisë së shkollës.

## **V - KOMISIONI DISIPLINOR**

### **Neni 13**

- 13.1. Masën disciplinore - ndërrim i shkollës e shqipton komisioni disciplinor.
- 13.2. Komisioni disciplinor e zgjedhë Këshilli i shkollës .
- 13.3. Komisioni disciplinor përbëhet prej 3 anëtarëve: dy mësimdhënësve dhe një prindi. Kryetar i Komisionit emërohet njëri prej mësimdhënësve .
- 13.4. Kërkesën për ngritjen e procedurës disciplinore kundër nxënësit e bënë drejtori i shkollës.

### **Neni 14**

- 14.1. Masa disciplinore vlenë më së shumti për një vit shkollor .

## **VI - DISPOZITAT KALIMTARE**

### **Neni 15**

Nëse ndonjë dispozitë e këtyre rregullave është në kundërshtim më dispozitat e Ligjit mbi Arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës, si dhe me udhëzimet ose aktet tjera, të cilat i ka nxjerrë MASHT-i, atëherë zbatohen dispozita e Ligjit, përkatësisht të nxjerrura nga Drejtoria Komunale për Arsim apo MASHT-i.

### **Neni 16**

Në fillim të vitit shkollor, secilit nxënës i ipet nga një kopje e këtyre rregullave, apo një në nivel të klasës.

### **Neni 17**

Gjatë zbatimit në praktikë, do të evidentohen rastet kur dhe ku duhet ndryshuar, riformular apo plotësuar Rregulloja.

### **Neni – 18**

Edhe ndryshimet eventuale të realitetit arsimor-edukativ nëpër shkollat tonë, mund të jenë bazë e mirë për ndryshime të Rregullores.

### **Neni -19**

Rastet karakteristike të praktikës sonë shkollore, që nuk janë të normuara me këtë Rregullore, apo i mungojnë fare, mund të zgjidhen me analogji nga praktika e mirë pedagogjike dhe nga rregullativat e tjera ligjore a nënligjore.

## VII - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni - 20

Kjo rregullore synon shkallë më të lartë demokratizimi dhe humanizimi brenda sistemit tonë arsimor-edukativ.

### Neni – 21

Rregullorja synon atmosferë pozitive në fryshtë e reformave arsimore, me qëllim që në shkollat tona, nxënësi të jetë subjekt qendror në mësim dhe në aktivitetet e lira të nxënësve.

### Neni – 22

Çdo ndryshim apo plotësim i Rregullores bëhet në përputhje me procedurën e ndjekur për hartimin filestar (aprovimin) e saj.

### Neni – 23

Asnjë nen, paragraf a nënparagraf i Rregullores nuk guxon të jetë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe udhëzimet administrative të MASHT –it .

### Neni – 24

Mangësitë e Rregullores mund të plotësohen me amandamentimin e saj.

### Neni – 25

Kjo Rregullore do të jetë në shërbim (moster) të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të komunës së Drenasit, si ndihmesë me rastin e hartimit të rregulloreve të atyre shkollave.

### Neni - 26

Kjo Rregullore hyn në fuqi për zbatim nga dita e miratimit nga mbledhja e Këshillit të Shkollës përkatëse.

Drenas: 03.11.2008

